

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" UNIVERS SOLAR ENERGY " SHPK

Sot, ne Fier, me date 21.03.2023, ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe te Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" me vullnetin e tyre te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e Statutit dhe te Akt Themelimit vendosen te formojne shoqerine:

I. THEMELIMI

Neni 1
Ortaku themelues

- I.1 Shoqeria " **UNIVERS SOLAR ENERGY "SHPK** themelohet nga ortaku I vetem:
- Z. Ylvi Sulejmani, shtetas shqiptare, lindur me 21.12.1965, ne Fier dhe banues ne Lagjia 1 Maj.Rruga Jani Bakalli.Godina e ish. DEPO e NTAN-it, tel:699237557, Fier - Shqiperi, me numer karte identiteti G51221033I, i cili zoteron 100% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise.

II. EMRI. SELIA. FORMA LIGJORE

Neni 2
Emri i shoqerise

- 2.1 Emri i shoqerise eshte " **UNIVERS SOLAR ENERGY "SHPK**.

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (SHPK), ne baze te ligjit Nr.9901,date14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".
- 3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblese se Ortakut te Vetem.

Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqeria " **UNIVERS SOLAR ENERGY " SHPK**, do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Statut, me Ligjin nr. 9901, date14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " si dhe dispozitat e tjera te Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Neni 5
Kohezgjatja

- 5.1 Shoqeria do te ushtroje veprimtarine per nje kohe mbi 20 vjet .
- 5.2 Veprimtaria e Shoqerise fillon qe nga momenti i regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit,Tirane.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen:, Lagjia 1 Maj.Rruga Jani Bakalli.Godina e ish.DEPO e NTAN-it, tel:699237557, Fier - Shqiperi.



- 6.2 Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.
- 6.3 Shoqeria ka te drejte te krijojte dege, filiale ose/dhe zyra perfaqesimi ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte vendit.
- 6.4 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera ekzistuese ose ne shoqeri qe ne te ardhmen do te zhvillojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte tij me vendim te ortakut te vetem te saj.

Neni 7

Vula

- 7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj qe do te perdoret nga administratori.
- 7.2 Forma e vules dhe permasat e saj do te percaktohen nga Ortaku i vetem i shoqerise, ne perputhje me kerkesat perkatese ligjore ne Shqiperi.

Neni 8

Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:
1. Projektim, ndertim, shfrytezim veprash energjitike me te gjitha llojet e burimeve natyrore dhe jo vetem. Tregtim energjie, shperndarje dhe transmetim. Ndertim linjash transmetimi te tensionit te ulet, te mesem dhe te larte.
 2. Aktivitete ne fushen e energjetikes, me synim gjetjen dhe shfrytezimin e burimeve energjetike , si dhe cdo ndertim tjeter me karakter civile dhe ekonomik perfshire Centralet fotovoltaike dh Hidrocentralet apo cdo objekt tjeter per prodhimin, shitjen e transmetimin e energjiise. Prodhimin dhe tregtimin me shumice e pakice te energjiise elektrike.
 3. Investime ne sektore te ndryshme te industrise si ne fushen e sherbimeve te ndertimit dhe te bujqesise. Realizimi i kontratave te siper marrjes, mareveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo i formave te tjera te lejuara nga legjislacioni shqiptar me persona fizike dhe juridike shqiptare apo te huaj per te realizuar operacione industrial tregtare dhe veprimtari te ndryshme qe jane te nevojshme dhe ne interes te shoqerise.
 4. Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem shqiptar.
- 8.2 Objekti i shoqerise mund te zgjerohet ose ndryshoje me Vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem.

Neni 9

Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000(njeqindemije) leke, i nenshkruar dhe pagesa e tyre eshte bere ne kesh ne arken e shoqerise.
- 9.2 Kapitali eshte i ndare ne 1(nje) pjese(kuota), dhe zoterohet nga:
1. Z.Ylvi Sulejmani i cili zoteron 1 kuote dhe 100% te pjesemarrjes se kuotave ne kapital e cila ne vlere leku eshte 100,000 leke(njeqinde mije leke).

Neni 10

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

- 10.1 Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt noterial.



- 10.2 Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen edhe te treteve me vendim te ortakut te vetem te shoqerise. Pjeset e kapitalit transferohen ne rruge trashegimnie pasi te jete marre Vendimi i Ortakut te vetem lidhur me kalimin e pjeseve te kapitalit tek trashegimtarete.

Neni 11

Zmadhimi/Zvogelimi i kapitalit themeltar

- 11.1 Ortaku I vetem I shoqerise mund te zmadhojne ose zvogelojne kapitalin themeltar me vendim te tyre. Zvogelimi i kapitalit themeltar do te kryhet brenda kufijve te lejuar nga ligji.

2. ORGANET E SHOQERISE

Neni 12

Asambleja e Ortakut te Vetem

- 12.1 Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi me i larte vendimor i shoqerise.
- 12.2 Asambleja e Ortakut te vetem drejton veprimtarine e shoqerise nepermjet marrjes se vendimeve. Mbledhjet e Asamblese jane te zakonshme.

Neni 13

Asambleja e Zakonshme

- 13.1 Asambleja e zakonshme vendos ne cdo rrethane ne emer te shoqerise. Ajo merr te gjitha vendimet (emerimi dhe shkarkimi i administratorit/eve, miratimin e bilancit te shoqerise, etj.) me perjashtim te atyre vendimeve qe ne baze te Ligjit ose Statutit jane ne kompetence te Asambese se Jashtezakonshme.
- 13.2 Asambleja e zakonshme i merr vendimet nga ortaket e saj me 51% te votave.

Neni 14

Thirrja dhe Perfaqesimi ne Asamble

Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem mund te thirret ne cdo kohe nga:

- Administratori/Administratorete;
- Ortaku i shoqerise.
- E te tjere konform ligjit

Neni 15

Njoftimi dhe Zhvillimi i Mbledhjeve

- 15.1 Mbledhjet zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te njoftuar nga administratori/njeri prej administratoreve.
- 15.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande, dhe poste tjeter te regjistruar, te pakten 15 dite perpara dates se zhvillimit te mbledhjes dhe permban daten, vendin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

Neni 16

Marrja e vendimeve

- 16.1 Vendimet merren nga ortaku i vetem i saj me 100% te votave.

Neni 17



Administrimi

- 17.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nga nje grup administratorësh qe caktohet nga Asambleja e Ortakut te Vetem.
- 17.2 Administratori/ret nuk eshte detyrimisht ortak i shoqerise.
- 17.3 Administratorët veprojnë ne menyre te pavaruar.
- 17.4 Administratori/ret kane te drejte te perfaqesoj shoqerine dhe te drejtoj punen e perditshme te shoqerise ne perputhje me udhezimet e Asamblese se Ortakut te Vetem.
- Administratori eshte solidarisht pergjegjes per veprimtarite e meposhtme:
 - drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise;
 - perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose duke caktuar zevendes.
 - perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose duke caktuar zevendes, veçanerisht ne marredheniet me bankat e nivelit te dyte dhe institucionet e tjera te kreditit, per hapjet e llogarive bankare dhe marrjen e kredive.
 - pergatitjen e mbledhjeve te Asambleve te Ortakeve;
 - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vete ose emerimin e nje kontabilisti te miratuar ose te nje eksperti kontabel;
 - pergatitjen e dokumenteve ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe ka;
 - lidh kontrata pune dhe i zgjidh ato sipas rastit;
 - Zhvillon veprimtari te tjera te cdo lloj natyre per te miren e shoqerise dhe realizimin e objektit te saj.
- 17.5 Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i cili do te jete:
- z. Ylvi Sulejmi i cila emerohet ne kete detyre per nje afat kohor prej 5(pese) vjet i cili fillon me 21.03.2023 deri me 20.03.2028.

Neni 18

Viti financiar

- 18.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Neni 19

Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

- 19.1 Bilanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet ne mbledhjet e Asamblese se Ortakut te vetem dhe I paraqitet organeve tatimore deri ne fund te muajit mars te vitit pasardhes.
- 19.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute.
- 19.3 Shoqeria mund te marre financime nga ortakët, institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Neni 20

Te ardhurat. Dividendi

- 20.1 Shoqeria do te krijojte fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.
- 20.2 Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, mund te terhiqen nga ortakut I vetem i shoqerise.

Neni 21



Likuidimi

- 21.1 Shoqeria do te hyje ne procesin e likuidimit, nese:
- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
 - Asambleja e Ortakut te vetem, vendos te prishe shoqerine.
- 21.2 Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likuidimit, Asambleja e Ortakut te vetem emerone nje likuidator ose nje grup likuidatoresh.
- 21.3 Likuidatori/likuidatorete raportoje mbi gjendjen e zerave te aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohe qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne fund te ketij procesi, Asambleja e Ortakut te vetem shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

Neni 22

Dispozita mbyltese

- 22.1 Ky Statut hartohet ne 2 (dy) kopje me fuqi te njejte ligjore ne gjuhen Shqipe.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

YLVI SULEJMANI



Fier, me 21.03.2023